



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**  
**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.03.2024

Ref. KM-70/24

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11. Shtojcën 1: pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**V E N D I M**

**Për Ndërprerjen e Memorandumit të Bashkëpunimit**

1. Ndërprehet bashkëpunimit i lidhur ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Institutit GAP dhe Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) e lidhur me datën 30 Mars 2023, nga palët nënshkruese, Ministri i MBPZhR-së z. Faton Peci dhe znj. Arbëresha Loxha Stublla, Drejtoreshë Ekzekutive GLPS-së.
2. Vendimi i ndërprerjes së bashkëpunimit është rezultat i shkeljeve të kushteve të marrëveshjes për bashkëpunim nga ana e Konsorciumit.
3. MBPZhR do t'i njoftojë zyrtarisht të gjitha palët pjesëmarrëse në marrëveshje për ndërprerjen e bashkëpunimit, duke i sqaruar arsyet e ndërprerjes dhe pasojat që mund të ndodhin.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe njoftohen të gjitha palët e përfshira në marrëveshje për bashkëpunim.
6. Ministria ruan të drejtën për të ndërmarrë hapa të tjerë ligjor në rast se Konsorciumi nuk ndërmerr hapa për përmirësimin e imazhit të MBPZhR-së.

## Ar sy e t i m

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara në Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Institutit GAP dhe Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) të datës 30 Mars 2023, i cili ka marrë përsipër që të gjitha njësitë organizative t'ju ofrojnë të dhëna publike dhe qasje të plotë monitoruesve të Konsorciumit përgjatë zbatimit të procesit të shpërndarjes së Grantëve dhe Pagesave Direkte, në rast nevoje. Ndërsa Konsorciumi merr përsipër që të menaxhoj me projektin në fjalë dhe që të dhënat dhe dokumentet e marra nga MBPZHR-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, të përdoren vetëm për qëllim të zbatimit të këtij projekti – konkretisht për qëllime hulumtimi dhe monitorimi, dhe se nuk mund të shfrytëzoj këtë Memorandum Bashkëpunimi për asgjë tjetër, përveç zbatimit të projektit të lartë cekur. Me këtë Memorandum të Bashkëpunim Palët janë pajtuar që të bazohen në parimet e transparencës së plotë, integritetit dhe angazhimit në mirëbesim ndërmjet tyre.

Bazuar në të thënat si më lartë, konsideroj se Konsorciumi nuk i ka respektuar dispozitat e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit duke mos i përdorur në mirëbesim dhe për qëllime të tjera siç përcaktohet me nenin 4 dhe 6 të këtij memorandumi duke bërë shkelje substanciale- mosrespektim, keqpërdorimin, keqinterpretimin dhe shfrytëzim të këtij bashkëpunimi të lidhur me dokumentet e marra nga MBPZHR, me cilat i krijon imazh jo të mirë dhe destruktiv këtij Institucioni.

Pra, ky Vendim është marrë pas një vlerësimi të kujdesshëm të deklaratave publike të zyrtares monitoruese, znj. Laura Nushi, të financuara nga projekti britanik, e cila ka përfshirë akuzat e mundshme të korrupsionit brenda institucionit. Me këtë rast vërehen shkelje të qarta të kushteve të marrëveshjes për bashkëpunim nga pala nënshkruese. Shkelja e kushteve ka prekur integritetin dhe mirëbesimin në mes të palëve dhe ka krijuar një situatë që kërkon ndërprerje të këtij bashkëpunimi.

Përparësia kryesore është ruajtja e imazhit dhe integritetit të MBPZHR-së. Ministria do të vazhdoj të mbështetet në ligjet dhe rregulloret aktuale për të garantuar respektimin e të drejtave dhe detyrimeve në këtë kontekst.

Me sa u tha me sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Z. Faton Peci**

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

*Vendimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit,*
  - *Zyrës së Sekretarit Përgjithshëm,*
  - *Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë,*
  - *Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS),*
  - *Institutit GAP, dhe*
  - *Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP)*
- Arkivit.*